REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E MITROVICËS-OPŠTINA MITROVICA
02 Nr.Prot./Br.Prot. 08-030/01-0003093/23
Nr i fq./Br.str.
Data/Datum 12.01.2023
Selia e Mitrovicës - Mitrovica

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut

Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm

PLANI DHE PROGRAMI I PUNËS PËR VITIN 2023

Drejtori: Ark Edison Tërnava

JANAR 2023

PËRMBAJTJA E PËRGJITHSHME

I. HYRJE
II. DREJTORIA
III. STAFI I DREJTORISË
IV. SEKTORI I PLANIFIKIMIT
V. SEKTORI I URBANIZMIT
VI. LEGALIZIMI
VII. BANIMI DHE
VIII ZYRTARI LIGJORË

I. HYRJE

DREJTORIA PËR PLANIFIKIM DHE URBANIZËM, NË BAZË TË ORGANOGRAMIT AKTUALISHT FUNKSIONON ME KATËR SEKTORË:

1. **SEKTORI PËR PLANIFIKIM**
2. **SEKTORI PËR URBANIZMËM**
3. **SEKTORI PËR LEGALIZIM**
4. **SEKTORI PËR BANIM DHE**
5. **ZYRTARI LIGJOR**

Kjo Drejtori me stafin e saj janë të obliguar të ndërmarrin hapat dhe veprimet procedurale, konform përgjegjësive për realizimin e objektivave të parapara sipas plan-programit të saj, me qëllim të inkorporimit dhe arritjes së strategjisë dhe objektivave të Planit, gjithnjë duke u bazuar në rregullativen ligjore, siq janë:

- Ligji për Ndërtimin nr.04/L-110
- Ligji për Planifikimin Hapësinor nr. 04/L-174
- Ligji për Financimin e Programeve të veqanta të Banimit nr.03/L-164
- Ligji për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040
- Aktet nënligjore, Udhëzimet Administrative dhe
- Statuti i Kuvendit të Komunës.

Andaj me qëllim të përcaktimit dhe arritjes së objektivave, Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm, duke vepruar në kuadër të përgjegjësive harton:

PLAN PROGRAMIN E PUNËS PËR VITIN 2023

II. DREJTORIA

DEKLARATA E MISIONIT:

MISIONI PARËSOR I DREJTORISË ËSHTË KRIJIMI I NJË AMBIENTI TË SHËNDOSHË DHE FUNKSIONAL: PËR BANIM, PUNË, SPORT, REKREACION, DUKE RESPEKTUAR RREGULLATIVËN EKZISTUESE LIGJORE.

PAS PËRFUNDIMIT TË PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË MIRATUAR PËR PERIUDHËN KOHORE 2020-2028, DREJTORIA ËSHTË BARTËSE E HARTIMIT TË HARTËS ZONALE TË KOMUNËS, QË ËSHTË NË PROCES TË PËRFUNDIMIT, HARTIMIT TË DETYRAVE PROJEKTUESE DHE PLANEVE RREGULLATIVE URBANE TË HOLLËSISHME.

BËNË IMPLEMENTIMIN E TYRE DHE LËSHON LEJET E NDËRTIMIT. KUJDESET PËR DOKUMENTACIONIN INVESTIVO-TEKNIK DHE PËRPUTHSHMËRINË E TIJ ME KUSHTET E DHËNA URBANO-TEKNIKE. LEJON SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE. MBULON SFERËN E BANIMIT. BASHKËPUNIMI I NGUSHTË ME QEVERINË - MINISTRINË E EKONOMISË AMBIENTIT DHE INFRASTRUKTURËS.

III. STAFI I DREJTORISË

Është e domosdoshme të theksohet fakti se, në disa raste na paraqiten vështirësi në arritjen e objektivave gjatë vitit kalendarik të punës, në mungesë të plotësimit të stafit punues me zyrtarë të rinjë e duke qenë se vite me radhë është zvogëluar përbërja e stafit për shkak të pensionimit të ish zyrtarëve. Mirëpo duke i pasur në konsideratë mundësitë e limituara buxhetore për rekrutimin e zyrtarëve të nevojshmëm për plotësimin e stafit të Drejtorisë, sipas planifikimit të bugjetit për vitin e ardhshëm 2023 kemi arritur që të planifikojmë buxhet për plotësimin e vendeve të nevojshme të punës:

1.Inxhinierë të Arkitekturës
1.Inxhinierë të elektros.
1.Inxhinierë të Gjeodezisë, njohës i programit GIS

Gjithnjë duke pasur parasysh nevojën edhe për më shumë staf punues në lëminë e inxhinierisë dhe 1 zyrtarë për buxhet dhe financa si dhe 1 asistent administrativ.
Andaj me qëllim të realizimit të objektivave të parapara me plan programin e drejtorisë dhe detyrave shtesë të paparapara, është më se e domosdoshme plotësimi i këtyre vendeve të nevojshme të punës gjatë vitit kalendarik 2023, me arsyen reale se është e pamundur të arrijmë rezultatet e duhura dhe të knaqshme, nëse vazhohet mbështetja në stafin aktual.

IV. SEKTORI I PLANIFIKIMIT

DEKLARATA E MISIONIT:

ËSHTË BARTËS I PËRGJEGJEGJËSISË INSTITUCIONALE PËR HARTIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL DHE HARTËS ZONALE TË KOMUNËS SI DHE ME MONITORIMIN DHE VLERËSIMIN E KËTYRE PLANEVE GJATË PROCESIT TË IMPLEMENTIMIT TË TYRE.

LËSHON LEJE PËR SHFRYTËZIMIN E HAPËSIRAVE PUBLIKE, KUJDESET PËR ZBATIMIN E LIGJEVE TË SFERËS SË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR, SI: LIGJIT Nr 04/L-174 PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR (LPH), SI DHE TË UDHËZIMEVE ADMINISTRATIVE TË MMPH-SË

IV.1. Planifikimi dhe objektivat e përgjithshme të sektorit të planifikimit:

1.1. Do të vazhdohet me procedurat ligjore deri në përfundimin e Hartës Zonale të Komunës

1.2. Do të vazhdoj me lëshimin e lejeve, sipas kërkesave për shfrytezimin e siperfaqeve dhe hapësirave publike,

1.3 Trajnime profesionale të stafit,

1.4. Bashkëpunimi me zyrën regjionale të Ministrisë së Ambientit dhe Infrastrukturës

1.5. Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare,

1.6. Përgaditja dhe propozimi i lokacioneve për objekte të karakterit të përgjithshëm,

1.7. Hulumtimi i donacioneve të mundshme dhe bashkëpunimi me donatorë të ndryshëm.

IV. 2. Zbërthimi dhe realizimi i objektivave:

2.1. Përfundimi i Procesit të Hartës Zonale Komunale.

Punët organizative janë të planifikuara si në:

- Pjesëmarrjen e Grupeve të interesit në proces të hartimit të HZK-së - si OJQ, shoqëria civile, Komuniteti i Biznesit etj.
- Sensibilizimin përmes mediave për procesin e hartimit të HZK-së.

IV.3. Lejet për shfrytezimin e siperfaqeve publike:

Duke u nisur nga fakti se, ky Sektor pranon në vazhdimësi një numër të konsiderueshëm të kërkesave për leje për shfrytëzimin e sipërfaqeve dhe hapsirave publike, gjerë më tani është shfrytëzuar Rregullorja Komunale nr. 01/2016, e cila me ndryshimin e rrethanave në aspektin e bizneseve, për një periudhë mjaft të gjatë kohore, pa u ndryshuar dhe plotësuar kjo Rregullore gjë që është zbehur mundësia për trajtimin adekuat të kërkesave të parashtruara për marrjen në shfrytëzim të sipërfaqeve dhe hapësirave publike për vendosje të objekteve të përkohshme nga subjektet që ushtrojnë veprimtari të ndryshme afariste të lejuara me ligj sipas akteve nënligjore që nuk e cënojnë rendin jurudik dhe ambientin. Nga kjo arsye kemi qenë medeomos të shtyrë që të inicojmë hartimin e Draft-Rregullorës së re Komunale e të cilën e kemi propozuar për miratim në Kuvend, për çka shpresojmë që pas aprovimit nga Kuvendi i Komunës dhe konfirmimi i ligjshmërisë nga Ministria përkatëse (MAPL), e njejta do të gjejë zbatim adekuat për mbulimin e

fushës në nxerrjen e akteve për lejimin e shfrytëzimit të sipërfaqeve dhe hapësirave publike për vendosje të objekteve të përkohshme.

IV.4. Trajnimet e stafit profesional:

Planifikojmë trajnimin e Planerëve në fushën e aplikimit të GIS-it (Sistemi Gjeografik Ndërkombëtar), të mbështetur nga nivele të ndryshme: nacionale, regjionale, komunale, lokale, etj., gjithnjë duke e angazhuar një profesionist të kësaj lëmije me një vendim të përhershëm, e në pamundësi, alternativë do të jetë angazhimi i përkohshëm.
GIS-i poashtu shërben për interpretimin e shumanshëm të të dhënave në forma dhe formate të ndryshme dhe racionalizon (kursen) kohën deri në 40% në raport me aplikimin e programeve tjera.

Kërkesat tona do jenë të parashtruara me shkrim zyrtarëve të MMPH-së, Un-Habitatit dhe Institutit për Planifikim dhe zotimit të tyre, e tëra kjo duke u bazuar në rezultatet dhe reagimet e anketës mbi përdorimin dhe zhvillimin e Programit Softverik të GIS-it, ku do të bëhet pregaditja e inventarit dhe raportimit i cili do të shërbej për të siguruar të gjitha informatat relevante, të specifikojë aktivitetet dhe të ofroj rekomandime për zhvillimet e mëtutjeshme në sistemin e informacioneve të bazuar në GIS.

IV.5. Bashkëpunimi me Ministrinë e Ambientit Ekonimisë dhe Infrastrukturës:

Bashkëpunimi me MAEI–në kryesisht është përqëndruar në dhënjen e raporteve të ndryshme dhe informative, nga aspekti i situatës urbane dhe të dhënave rreth profileve të ndryshme të qytetit sipas nevojës që MAEI-ja i sheh të arsyeshme dhe i kërkon. Këtu duhet veçuar obligimet tona si Komunë me dërgimin e të gjitha Planeve Hapësinore (Hartës Zonale Komunale, Planit Rregullues të Hollësishëm) në formatet digjitale dhe tekstuale si dhe nevojat tona për ndihmesën nga MAEI për Hartën Zonale. (me punëtori dhe trajnime).

IV.6. Bashkëpunimi me institucionet ndërkombëtare:

Bashkëpunimi me këto institucione janë çështjet e përgjithshme dhe modalitete të natyrave të ndryshme. Kryesisht në aspektin e Donacioneve si dhe trajnimeve dhe punëtorive në fusha të ndryshme.

IV.7. Përgaditja dhe propozimi i lokacioneve për objekte të karakterit të përgjithshëm:

Pas miratimit dhe fuqizimit të Planit Zhvillimor Komunal , mbetet obligim i planifikuar që konform nevojave të parashtruara të shqyrtojmë dhe hartojmë edhe propozimin e lokacioneve për objektet e infrastruktures Publike: arsimore, shëndetësore, sportive, në mënyrë që pastaj sipas anës procedurale përmes hallkave institucionale të aprovohen.

Me finalizimin e Hartave Zonale , do të zgjerohen mundësitë për dhënien e pëlqimeve për lokacione dhe mikrolokacione edhe për nevoja të tjera, dhe ngritet efikasiteti i këtij sektori në

përmbushjen e obligimeve ndaj kërkesave të shumëta të qytetarëve (Investitorëve potencial) që do të ndikonin edhe në zbatimin e PZHK-së.

IV.8. Hulumtimi i donacioneve të mundëshme dhe bashkëpunimi me donatorë:

Pas miratimit nga Asambleja Komunale e Hartave Zonale, si dhe aprovimit nga ana e MAEI-së, planifiojmë të aplikojmë për donacione dhe investime të mundshme tek organizmat kombëtar dhe ndërkombëtar që ndërlidhen me sferat e interesit të përgjithshëm të shoqërisë në fushat: Shëndetësi, Arsim, Agrokulturë, Mbrojtje të Ambientit, Infrastrukturorë, etj.

V. SEKTORI I URBANIZMIT

DEKLARATA E MISIONIT:

KUJDESET PËR IMPLEMENTIMIN E PLANEVE ZHVILLIMORE DHE PLANEVE RREGULLUESE URBANE, LËSHIMIN E LEJEVE TË NDËRTIMIT KONFORM RREGULLATIVAVE EKZISTUESE, KONTROLLIMIN E DOKUMENTACIONEVE INVESTIVO-TEKNIKE, SHFRYTËZIMIN E SIPËRFAQEVE PUBLIKE NË PËRPUTHJE ME RREGULLORET DHE REALIZIMIN E MJETEVE FINANCIARE, DUKE PARAQITUR SHTYLLËN KRYESORE TË TË HYRAVE VETANAKE NË BUXHETIN KOMUNAL.

V.1. Planifikimi dhe objektivat gjenerale të sektorit të urbanizmit:

1.1. Bashkëpunimi dhe ndihma profesionale në hartimin e Hartës Zonale Komunale.

1.2. Shqyrtimi i kërkesave dhe udhëheqja e procedurës komplete për Leje të Ndërtimit,

1.3. Vazhdimi i procedurës për pajisje me leje ndërtimi për objektet e ndërtuarara nga donatorë të mundshëm.

V. 2. Zbërthimi dhe realizimi i objektivave:

2.1. Bashkëpunimi dhe ndihma profesionale në hartimin e planeve të Hollsishme Rregulluese urbane.

Drejtoria - Sektori i Urbanizmit, disponon me pesë (6) Plane Rregulluese Urbane, të hartuara paraprakisht dhe të aprovuar nga Kuvendi Komunal. Edhe pse objektiv permanent i drejtorisë është implementimi i tyre, në vepër ekzistojnë vështirësi dhe ngecje në këtë drejtim.

2.2. Shqyrtimi i kërkesave dhe udhëheqja e procedurës komplete për Leje Ndërtimi:

Edhe përkundër aktiviteteve të shumta të cilat na presin, planifikojmë që shqyrtimi I kërkesave për leje të ndërtimit të shqyrtohen me kohë dhe lëshimi i lejeve të ndërtimit për kategorinë e I-rë dhe të II–të të përfundohet Brenda afatit të paraparë ligjorë për lëshimin e tyre.

2.3. Vazhdimi i procedures për pajisje me leje ndërtimi dhe shërbime tjera, për objektet me donacion nga donatorë vendorë dhe ndërkombëtar si dhe me bashkëfinancim:

Është aplikuar që në vitin 2023, ta kemi në shfrytëzim SOFTWER-in, për digjitalizimin e lejeve të ndërtimit.

Edhe për vitin që vjen presim Investime nga niveli Qendror, për objekte Arsimore, si: shkolla fillore, të mesme, shkollë të muzikës, qerdhe etj.

MKRS në bashkëpunim më Drejtorinë për Planifikim dhe Urbanizëm do të bashkpunojë në të gjitha procedurat për Leje Ndërtimore dhe për objektet të cilat i financon MKRS.

VI. I LEGALIZIMI

Gjer me tani Legalizimi ka funksionuar vetëm si Zyre për Legalizim, mirëpo në gjysmën e dytë të vitit, në bazë të Rregullores Komunale Nr. 01/2022, për Organizimin, Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Administratës Komunale, si dhe në kuadër të Organogramit të DPU-së, është shndërruar në Sektor për Legalizim.

Trajtimi i Ndërtimeve Pa Leje – Legalizimet:

Duke pas parasysh faktin se, edhe përkundër shqyrtimit të një numri të konsiderueshëm të kërkesave për trajtimin e ndërtimeve pa leje- legalizimet, është arritur rezultat i knaqshëm në dhënien e përgjigjeve të gjitha rasteve të aplikuara. Krahas kësaj një numër I këtyre aplikimeve kan ngecë për shkak të skadimit të ligjit. Mirëpo me rastin e vazhdimit të Ligjit përkatës për trajtimin e ndërtimeve pa leje, planifikojmë që të shqyrtojmë dhe të përfundojmë një numër të konsiderueshëm të ndërtimeve pa leje.
Krahas shqyrtimit të lëndëve, si dhe marrja e Vendimeve për të gjitha lëndët e shqyrtuara dhe ate:

a) Vendime për Dhënjen e Certifikatës së Legalizimit
b) Vendime për Listë të Pritjes dhe
c) Vendime për Rrënim

Vendimet merren varësisht nga gjendja aktuale e ndërtimeve pa leje (të përfunduara, të papërfunduara), shtrirjen e objekteve në hapsirë afër (zonave të mbrojtura, në toka bujqësore nën komasacion, në prona komunale, shoqërore, infrastrukture), plotësimin e dokumentacioneve të pa kompletuara.
Për të gjitha Vendimet në Listën e Pritjes do të mirren Vendime të reja në kontinuitet në bazë të ofrimit të dëshmive nga palët në bazë të Ligjit në fuqi dhe Udhëzimeve Administrative.

Aktivitetet tjera të Sektorit për Leglizim

- Sektori do të vazhdojë të kordinojë punët me Ministrinë e Infrastruktures dhe Ambientit në vazhdimësi për Legalizimin e ndërtimeve pa leje në Komunën tonë.
- Sektori do të bashkëpunoj me USAID-in me të dhëna dhe informata sipas kërkesave të tyre si mbështetse në implementimin e këtij Ligji dhe Udhëzimeve Administrative.
- Do të raportojë në Ministri sipas kërkesës së tyre siq ka qenë edhe më parë.
- Në vazhdimësi do të pranohen palët për informim për procesin e Legalizimit.
- Udhëzimin e palëve për legalizimin e ndërtimeve pa leje.
- Do të bashkëpunojë ngushtë me Drejtorinë për Gjeodezi Pronë dhe Kadastër.

Do të bashkëpunojë me të gjitha komunitetet, OJQ-të, Shoqërinë Civile, UN-habitat, OSBE, dhe të gjitha palët e interesuara për procesin e Legalizimit.

VII. BANIMI

DEKLARATA E MISIONIT:

KRIJON DHE MIRËMBANË DATABAZËN NË SFERËN E BANIMIT, KUJDESET PËR BANESAT DHE HAPËSIRAT AFARISTE PRONË KOMUNALE PËRMES RREGULLIMIT TË KONTRATAVE PËR SHFRYTËZIMIN E TYRE DHE HARTON PLANPROGRAME DHE PROJEKTE PARALLOGARITARE PËR MIRËMBAJTJEN OBJEKTEVE SHUMËBANESORE.

Deri më tani kemi pasur ngecje për shkak të mos formimit të sektorit për banim. Kurse tani në bazë të Rregullores Komunale Nr. 01/2022, në Kuadër të Organogramit të Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm, zyra për Banim, tani është Sektori për banim, të cilin presim që ta funksionalizojmë, me anë të plotësimit të stafit me së paku edhe 1 (një) dy zyrtarë, në mënyrë që i njejti të ushtroj funksionin dhe përgjegjësit për të cilat është formuar.

Gjatë këti viti kalendarik, me vendim të kryetarit të Komunës është formuar Komisioni komunal për Hartimin e programit tre vjeçar të banimit, si dhe në Kuvendin e Komunës është miratuar vendimi për Programin tre vjeçar të banimit për periudhen kohore 2022-2025.

Pastaj ky Plan është Miratuar nga Kuvendi në Mars të vitit 2016, e që tani është I skaduar.

Po ashtu presim që përmes këtij sektori parashihet dhe është ligjerisht i obliguar që të formohen këshillat e banimit në objektet shumëbanesore.

VII.1. Planifikimi dhe objektivat gjenerale të nënsektorit të banimit:

1.1. Bashkëpunimi dhe ndihma profesionale në hartimin dhe implementimin e PZHK–së, Hartës Zonale dhe PRRHU,

1.3. Formimi dhe mirëmbajtja e regjistrit të banesave në pronësi të Komunës.

1.4. Krijimi dhe menaxhimi i politikave të qerasë për banesa dhe lokale (në pronësi komunale),

1.5. Krijimi i arkivit për Ndërtesa Shumëbanesore të banimit.

1.6. Zbatimi i aktivitetit për vendosjen e familjeve përfituese të shtëpive në Frashër.

VII.2. Zbërthimi dhe realizimi i objektivave:

2.1. Bashkëpunimi dhe ndihma profesionale në hartimin dhe implementimin e planeve rregulluese të Hollësishme Urbane dhe Hartës Zonale të Komunës. Planifikojmë të japim kontributin maksimal nga sektori ynë në fazën e hartimit dhe kompletimit të tyre.

2.3. Formimi dhe mirëmbajtja e regjistrit të banesave nëpronësi të Komunës. Pasi sektori i banimit nuk funksionon në masën e planifikuar por vetëm pjesërisht me një të punësuar kemi planifikuar të inicojmë disa prej aktiviteteve të mundshme si bie fjala: angazhimi i një kompanije profesionale për të bërë vlerësimin në aspektin e stabilitetit të të gjitha objekteve të banimit kolektiv që kanë kulme të rrafshta me qëllim që në rend të parë të eliminohen dëmtimet dhe rrjedhjet e ujit me vendosjen e kulmeve të pjerrta, dhe aty ku lejohet në aspektin e stabilitetit të bëhen banesa në nënkulme.

Realizimi i këtijë objektivi do të bëhej me koncesion duke përzgjedhë me konkurs ndonjë kompani profesionale.
Ngjyrimi dhe sanimi i fasadave të dëmtuara të objekteve të banimit kolektiv.
Formimi dhe mirëmbajtja e regjistrit të banesave në pronësi komunale me çka do të arrinim të krijonim material për azhurim, mirëmbajtje dhe arkiv.
2.4. Krijimi dhe menaxhimi i politikave të qerasë për banesa, lokale. Gjatë pjesës së parë të vitit do të inicojmë procedurat rreth krijimit dhe menaxhimit të politikave të qerasë për banesa dhe lokale të cilat janë në pronësi të Komunës si projekt i cili kërkon mbështetje dhe ndihmë edhe nga drejtoritë tjera përkatëse.
2.5. Krijimi i arkivit të banimit për ndërtesat shumëbanesore. Është projekt ambicioz dhe voluminoz në të cilin planifikojmë të vazhdojm.

VII.Aktivitet Finaciare

- Arrijta e objektivave për realizimin e Planit financiar.
- Arritja e Planifikimit të Buxhetit të Drejtorisë si dhe Realizimi i tij.
- Tejkalimi i të hyrave vetanake nga planifikimi i bërë.
- Inkasimi i të hyrave vetanake ndër vite.

VIII. ZYRTARI LIGJORË

VIII.1. Bazuar në përshkrimin e përgjegjësive dhe detyrave të punës si dhe sipas Organogramit të Drejtorisë, është përgjegjës ndaj Drejtorit të Drejtorisë për çështje ligjore dhe procedura administrative. Gjatë këtij viti e ka kryesuar Komisionin e formuar me vendim të Kryetarit të Komunës, për hartimin e Draft Rregullorës Komunale për procedurat e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës pas propozimit, është miratuar nga Kuvendi i Komunës dhe po ashtu e ka marrë konfirmimin e ligjshmërisë nga MAPL-ja, dhe e njejta është publikuar në web faqën zyrtare të Komunës si Rregullore Komunale Nr. 03/2022.

Aktualisht është në proces dhe i është propozuar Kuvendit të Komunës për miratim Draft Rregullorja e re për kriteret e vendosjes së objekteve të përkohshme në sipërfaqe dhe hapësira publike, e cila nëse miratohet nga Kuvendi i Komunës dhe e merr konfirmimin e ligjshmërisë nga MAPL-ja, do të jetë e zbatueshme dhe e implementueshme si Rregullore Komunale.
Për vitin 2023, do të vazhdohet me nxjerrjen e Akteve Administrative, me hartimin e propozim vendimeve sipas nevojave të paraqitura në Drejtori, me qëllim që të nxirren vendime nga Kuvendi i Komunës si instance e vendim marrjes.
Poashtu do të veproj në kontinuitet të plotë për ofrimin e bahskëpunimit në aspketin juridiko-administrativ me stafin e Drejtorisë si dhe me ofrimin e këshillave ligjore sipas nevojës për zgjedhjen e çështjeve juridike.
Do të ndërmerr veprime në kuadër të detyrave dhe përgjegjësive sipas kërkesave të Drejtorit të Drejtorisë, gjithnjë në respektim të plotë të Ligjeve të fuqi dhe aketeve tjera nënligjore, udhëzimeve administrative dhe Rregulloreve Komunale.

IX. AKTIVITETE NDËR SEKTORIALE

IX.1. Mbikëqyrjet profesionale dhe komisionet

Aktivitetet ndërsektoriale është emëruesi i përbashkët për të gjitha detyrat dhe aktivitetet të cilat kërkohen të ndërmirren në bazueshmëri profesionale të stafit të drejtorisë pavarësisht sistemimit të tyre në sektorët përkatës. Këto aktivitete dhe detyra janë të karakterit professional në cilësi të mbikëqyrjeve të ekzekutimit të punimeve për objektet, investitor i së cilës është Komuna, apo është donacion, në cilësi të anëtarëve të mundshëm në komisione përkatëse.

1.2. Bashkëpunimi me Kompanitë publike: KEDS-i, PTK-ja, Ujësjellësi Rajonal, "UNITETI".

1.3. Shqyrtimi i kërkesave të palëve.

Komform kërkesave të qytetarëve apo subjekteve planifikojmë ngritjen e efikasitetit të shqyrtimit të tyre dhe përgaditjen e përgjigjeve meritore sipas rregullativës ligjore.

PËRFUNDIMI

Krijimi i kushteve për një ambient të shëndoshë për banim, punë, sport, rekreacion dhe ruajtjen e menagjimin e objekteve Komunale, është misioni parësor i Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm, i cili mund të ndërtohet shumë më lehtë dhe më shpejtë me angazhimin e të gjithë akterëve relevant në të gjitha fazat e planifikimit, përmes gjetjes së strategjisë për veprim të tyre.

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E MITROVICËS OPŠTINA MITROVICA MITROVICE-MITROVICA REPUBLIKA KOSOVO

Drejtori I DPU-së

Edison Tërnava.inxh.ark